



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 630/6 prot.

Tiranë, më 26.03.2025

VENDIM

Nr.02, datë 26.03.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës nr. 630 Prot., datë 06.02.2025 (saktësuar me nr. 630/1 Prot., datë 13.02.2025), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 23.12.2024, depozituar në adresat elektronike info@qkl.gov.al ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni si vijon:

1. Dokumentin/dokumentet zyrtarë me të cilat është përzgjedhur/emëruar Juria e Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023;
2. Proces verbalin e zgjedhjes së kryetarit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023;
3. Rregulloren e funksionimit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023;
4. Numrin e protokollit dhe datën e secilës kontratë të nënshkruar me secilin prej anëtarëve të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023, të shoqëruar me kopjen përkatëse të secilës kontratë;

5. *Kopje të proces verbalit të mbledhjes ku janë përcaktuar nga QKLL-ja dhe plotësuar nga anëtarët e jurisë kriteret mbi të cilat është ngritur puna e tyre për këto çmime;*
6. *Informacion dhe dokumentacion për shpalljen e konkursit letrar “Qytetet e padukshme” shpallur më 27.09.2024:*
 - a. *Cila është Juria? b. Në cilën fazë është ky projekt?*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 24.12.2024, ka vendosur në dispozicion shkresën me nr. 751 Prot., datë 24.12.2024 me anë të së cilës ka informuar kërkuesin në lidhje me kërkesën objekt shqyrtimi, duke sqaruar konkretisht se: *“Për pikën 1: Juria e Çmimeve Kombëtare e Letërsisë për vitin 2023 është ngritur bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Çmimeve Kombëtare të Letërsisë, Kreu III, neni 5, pika 1, ku thuhet: “Juria emërohet nga drejtori i QKLL-së. Emrat e jurisë diskutohen në mbledhjen e Kolegjiumit në fillim të vitit kalendarik”. Në procesverbalin e mbledhjes së Kolegjiumit datë 23.01.2024, nr. 41 prot., anëtarët e tij kanë propozuar një listë emrash nga të cilët me Urdhër nr. 11, datë 29.01.2024 janë emëruar si anëtarë të Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023: z. Blendi Lami, përkthyes, z. Koloreto Cukali poet, znj. Entela Kasi poete, z. Xhevat Lloshi studiues, znj. Monika Stafa gazetare kulture.*

Për pikën 2: Referuar Rregullores së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë kreu III, neni 6, pika 2 ku thuhet “Zgjedhja e kryetarit bëhet në mbledhjen e parë të jurisë”, në mbledhjen e parë të Jurisë të mbajtur më datë 19.02.2024, nr. 113 prot., është vendosur mes tyre që z. Koloreto Cukali të jetë kryetar i këtij edicioni. Porcesverbali i mbledhjes është i firmosur nga të 5 anëtarët e jurisë.

Për pikën 3: Rregullorja është bashkëlidhur.

Për pikën 4: Nr. 70 prot, dt 29.01.2024, z. Xhevat Lloshi

Nr. 71 prot. dt. 29.01.2024, znj Monika Stafa

Nr. 77, prot, dt. 29.01.2024 znj Koloreto Cukali

Nr. 78, prot, dt 29.01.2024 znj. Entela Kasi

Nr. 79, prot.dt 29.01.2024 z. Blendi Lami

Referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, neni 3, pika 4, kontratat e mësipërme përmbajnë të dhëna personale të subjekteve, si të tilla ato nuk mund të jenë publike. Gjithashtu, referuar ligjit të mësipërm, nenit 17, pika 4 “kërkesa është e paqartë”.

Për pikën 5: Procesverbalet nuk mund të bëhen publike për sa kohë, konkursi është në proces, pasi përmbajnë informacione kofidenciale mbi diskutimet e veprave, autorëve konkurues, qëndrime të ndryshme të anëtarëve mbi veprat në gjykim. Kriteret janë detyrë e jurisë. Deri tani pranë QKLL, janë depozituar 5 procesverbale të firmosura nga të 5 anëtarët e jurisë.

Referuar Rregullores së funksionimit të jurisë nenit 8, pika 3, ku thuhet “Juria, pas përfundimit të çdo faze shqyrtimi dhe vlerësimit të veprimtarisë artistike dhe kulturore, dorëzon dokumentacionin në zyrën e protokoll/Arkiv të Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, procesverbalet e mbledhjeve të jurisë janë protokolluar me numrat si më poshtë:

1. *Mbledhja I Nr.113 Prot., dt.19.02.2024,*
2. *Mbledhja II Nr. 570 Prot., dt.09.09.2024,*

3. *Mbledhja III Nr.570/1 Prot., dt. 25.09.2024,*
4. *Mbledhja IV Nr. 695 Prot., dt 21.11.2024,*
5. *Mbledhja V Nr. 740 Prot., dt 17.12.2024.*

Për pikën 6: Në kuadër të aktiviteteve me rastin e 80-të vjetorit të Çlirimit të vendit, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit konceptoi disa ide aktivitete për t'i realizuar përgjatë këtij viti të rëndësishëm historik, si konferenca, ekspozitë me vizatime të dëshmorëve të luftës, promovime dhe konkursin drejtuar autorëve shqiptarë “Qytetet e padukshme”...

Në këto kushte, referuar Rregullores, por dhe procedurave të funksionimit të projekteve të tilla nuk ka patur asnjë juri të emëruar për këtë konkurs dhe asnjë fond të brendshëm të elakuuar për këtë projekt.”

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi me e-mail-in datë 27.12.2024 i është drejtuar edhe njëherë Autoritetit Publik duke sqaruar se në përgjigjen e sipërcituar mungon dokumentacioni i kërkuar.

Në mungesë të një përgjigje, në vijim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar në pikën 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”).

Në përputhje me nenin 10, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”,* Komisioneri, me shkresën nr. 630/2 prot., datë 17.02.2025, kërkoi nga Autoriteti Publik, sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar për secilën nga pikat e kërkesës, qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe argumentimin përkatës në rast të kufizimit të së drejtës për informim, bazuar në nenin 17 të LDI.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 125 Prot., datë 24.02.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 630/3 Prot., datë 25.02.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...dokumentet që ish-punonjësi i QKLL-së kërkon, në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 17 “Kufizimi i së drejtës për informim”, pika 2, germa dh) barazia e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nuk mund të vërë në dispozicion asnjë prej dokumenteve të sipër kërkuara, pasi institucioni ynë është në proces gjyqësor me ish-punonjësin e saj , që nga data 16.05.2023 e në vazhdim.”*

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet shkresës nr. 630/4 prot., datë 25.02.2025, Komisioneri ftoi Autoritetin Publik në një seancë dëgjimore. Seancë kjo e cila u zhvillua në datën 04.03.2025, me prezencën e koordinаторit për të drejtën e informimit të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, koordinatori rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar nga Autoriteti Publik në shkresën nr. 125 Prot., datë 24.02.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 630/3 Prot., datë 25.02.2025. Ndërkohë, Zyra e Komisionerit parashtrori se nga përgjigja e Autoritetit Publik mbeten të paqarta ende dy momente, konkretisht, ekzistenca e një procesi gjyqësor dhe nëse dokumentacioni i kërkuar cënon barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Pra, nëse ky dokumentacion është apo jo pjesë e procesit gjyqësor dhe nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit administrativ.

Në këto kushte, në pamundësi për t’i sqaruar këto paqartësi në seancë, i’u la detyrë koordinatorit që brenda datës 06.03.2025, të provonte ekzistencën e procesit gjyqësor, si dhe lidhjen e këtij procesi me secilën nga dokumentat e kërkuara në kërkesën për informacion datë 23.12.2024.

Në vijim, koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 11.03.2025, sqaron se “info” e institucionit është hakeruar, ndërsa përgjigja është nisur që në datën 06.03.2025. Konkretisht, në përgjigjen bashkëlidhur këtij e-mail-i, Autoriteti Publik, ka vendosur në dispozicion të ankuesit edhe njëherë informacionin si e dërguar me shkresën nr.751 Prot., datë 24.12.2024, duke sqaruar gjithashtu se: *“...Lidhur me kërkesat mbi akses në procesverbalet dhe punën e jurisë, i kujtojmë LDI, nenin 3, pika 4 ku thuhet se: “me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”. Referuar fyerjeve dhe gjuhës jashtë etikës që z. ka referuar në postimet e tij publike kundrejt jurisë së këtij Konkursi të rëndësishëm dhe Qendrës e drejtueses së saj, duke dëmtuar imazhin e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit dhe të Jurisë, i kujtojmë sërish LDI, neni 17.”*

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, nëpërmjet e-mail-it datë 20.03.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 630/5 Prot., datë 20.03.2025, ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion dokumentacionin përkatës lidhur me pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion datë 23.12.2024.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj...”. Në kuptim të këtij parashikimi, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.*

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 3, LDI, përcakton se: *“1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.”*

Bazuar në këto parashikime, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik është i detyruar të zbatojë detyrimet e LDI ndërsa, përgjegjësia për tjetërsimin e informacioneve bie mbi individin që merr apo përdor këtë informacion. Pretendimi për kufizimin e informacionit publik për shkak të një dëmi të ardhshëm, të mundshëm, si pasojë e keqpërdorimit të informacionit publik, nuk përbën bazë ligjore për kufizim.

Në rast keqpërdorimi të informacionit publik nga ana e kërkuesit, Autoriteti Publik ka në dispozicion instrumentet ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të shkelura.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të administruara dhe cituar më sipër, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion informacionin lidhur me pikën 6 *“Informacion dhe dokumentacion për shpalljen e konkursit letrar “Qytetet e padukshme” shpallur më 27.09.2024: a. Cila është Juria? b. Në cilën fazë është ky projekt?”*, të kërkesës për informacion datë 23.12.2024, për të cilën nga ana e ankuesit nuk është depozituar ankim.

Për sa i përket pikës 3 *“Rregulloren e funksionimit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023”*, Autoriteti Publik deklaroi se e ka vendosur në dispozicion për kërkuesin, por në asnjë nga përgjigjet e kthyerat nuk rezultoi si dokument bashkëlidhur. Fakt ky i vërtetuar nga ankuesi si në ankesën e depozituar, gjithashtu edhe në vijimin e tij. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se kjo pikë e kërkesës mbetet e papërmbushur dhe rrjedhimisht ky kërkim duhet pranuar.

Nga analizimi i kësaj pike, rezultoi se kemi të bëjmë me një dokument/rregullore që lidhet me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Autoritetit Publik dhe interesi publik

për t'a aksesuar atë është i lartë. Komisioneri konstaton se ky dokument përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë, bazuar kjo, në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 7 të LDI, në të cilat parashikohet se: “1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

ii) të ligjeve;

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë...

Ndërkohë, në lidhje me pikat 1, 2, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik, në mënyrë të përmbledhur ka kthyer një përgjigje nëpërmjet shkresës me nr. 751 Prot., datë 24.12.2024, si dhe e-mail-it datë 11.03.2025, por, nuk e ka shoqëruar atë me dokumentacionin përkatës, në kundërshtim kjo me kërkesën për informacion në të cilën ankuesi ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion një kopje e dokumentacionit të zotëruar.

Gjithashtu, Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë për secilën nga pikat e kërkesës, në kundërshtim kjo me LDI, shkresën nr. 630/2 Prot., datë 17.02.2025 të Zyrës së Komisionerit, ku ndër të tjera i është kërkuar: “...s qarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar për secilën nga pikat e kërkesës, qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe argumentin përkatës në rast të kufizimit të së drejtës për informim, bazuar në nenin 17 të LDI...”, si dhe detyrën e lënë në seancën dëgjimore datë 04.03.2025.

Megjithatë, duke analizuar përgjigjet që ka kthyer Autoriteti Publik se: “...Lidhur me kërkesat mbi akses në procesverbalet dhe punën e jurisë, i kujtojmë LDI, nenin 3, pika 4 ku thuhet se: “me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji...”, Komisioneri vlerëson se në këtë rast gjen zbatim pika 2, e nenit 44, e ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në të cilën parashikohet se: “... Aksesi i publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesi i publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar

rastesh...". Rrjedhimisht, bazuar në këtë dispozitë, pretendimi i Autoritetit Publik nuk qëndron dhe këto kërkime duhen pranuar.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik, Komisioneri konstaton gjithashtu se, kufizimi i informacionit është bërë në referim të shkronjës "dh" të pikës 2 të nenit 17 të LDI, pa marrë parasysh pikën 6 të këtij neni në të cilën citohet se: *"6. Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton se Autoriteti Publik të ketë bërë një vlerësim të dokumentacionit të kërkuar, por është mjaftuar vetëm me vënien në dispozicion të informacionit që përmbajnë dokumentat objekt shqyrtimi, qëndrim ky në kundërshtim me kërkesën për informacion, si dhe dispozitën e sipërcituar.

Autoriteti Publik nuk arriti në asnjë moment të provonte ekzistencën e procesit gjyqësor, si dhe lidhjen e këtij procesi me dokumentat objekt shqyrtimi, të cilat, për rrjedhojë mund edhe të cënonin barazinë e palëve në procesin gjyqësor.

Për sa më sipër parashtruar, si dhe në kushtet kur Autoriteti Publik deklaroi se e disponon dokumentacionin, objekt ankese, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: *"Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik".* Rrjedhimisht, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit dokumentacionin e kërkuar në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Personat përgjegjës për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar duhet të tregojnë kujdes në fshirjen e të dhënave të personave të tjerë të cilët përmenden në mënyrë sporadike në këto dokumente. Në këto raste identiteti i tyre, por edhe të dhëna të tjera të cilat mund t'i identifikojnë ato në mënyrë indirekte duhet të bëhet në formë të anonimizuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 630 Prot., datë 06.02.2025 (saktësuar me nr. 630/1 Prot., datë 13.02.2025), ndaj Autoritetit Publik, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 23.12.2024, konkretisht: (1. Dokumentin/dokumentet zyrtarë me të cilat është përzgjedhur/emëruar Juria e Çmimeve Kombëtare të Letërisë për vitin 2023; 2. Proces verbalin e zgjedhjes së kryetarit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërisë për vitin 2023; 3. Rregulloren e funksionimit të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërisë për vitin 2023; 4. Numrin e protokollit dhe datën e secilës kontratë të nënshkruar me secilin prej anëtarëve të Jurisë së Çmimeve Kombëtare të Letërisë për vitin 2023, të shoqëruar me kopjen përkatëse të secilës kontratë; 5. Kopje të proces verbalit të mbledhjes ku janë përcaktuar nga QKLL-ja dhe plotësuar nga anëtarët e jurisë kriteret mbi të cilat është ngritur puna e tyre për këto çmime), duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës _____.____.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë _____.____.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi